



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE

Adresa: Bashkia Kolonje "Sheshi Rilindja" 7401 Erseke, Kolonje Albania, Web: www.kolonja.gov.al, Email : info@kolonja.gov.al

PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE: 30 Gusht 2022

VENDI: *Fshati Clirim*

ORA: *12:00*

Tema e Konsultimit: *Mbledhja e Rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per projekt-buxhetin afatmesem 2023-2025.*

Baza Ligjore: *Ne mbeshtetje dhe ne zbatim te Ligjit Nr.146/2014 "Per njoftimin dhe Konsultimin Publik" neni 11 pika 2, Ligji Nr. 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore" neni 34, Ligjit Nr.68 /2017 "Per financat e veteqerisjes vendore", ligjit nr.9936, date 26.06.2088, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar,ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.*

Pjesemarres: *Kryetari i Bashkise Z.Erion Isai, Kryetarja e Keshillit Bashkiak znj. Donika Xhelili, Sekretarja e Pergjithshme Znj. Sofika Rrexhepi, Nenkryetari Aldo Jaho, Pergjegjese Mimoza Gora, drejtori i ujesjellsit, Rreth 40 banore te zones.*

- **Kryetari z.Erion Isai.**

Jemi te vetedijshem dhe koshiente per zonen e clirimit, e di qe problemi kryesor per ju eshte rruga. Ne si bashki kemi pergatitur per te aplikuar me projektet e BE-se per te bere rrugen me asfalt , me fondet tona nuk kemi mundesi. Numri i popullsise na i kushtezon disa gjera.

- **Znj.Elina Hado .**

Na duhet rruga ne fshatin Kaltanj. Rruga duhet me kanale anash qe te mos priset. Ne si fsjat kete kemi problemin kryesor rrugen.

Klorifikimi i ujesjellsit.

- **Z.Bajram Muharremi**

Na keni premtuar rrugen per ta bere me trotuar, me zgjerim dhe me kanale. Administratori i ri duhet te vendoset shpjjet. Duam mirembajtjen e rruges se fshatit, me cakull dhe kanale anesore.

- **Z.Pellumb Seiti nga fshati Luaras.**

Dhe ne si fshat duam te na behet rruga dhe ujesjellesi ne kete fshat. Rruga do mirembajtje cdo vit. Duam dhe nje punetor per rruget ne keto fshatra.

- **Z.Albin Ajdini nga Kurtesi**

Ne si problem kemi uren e Orgacves kemi 3 vjeti. Duhet bere ura para se te vijne ujrart e lumit. Ujesjellesi i Kurtesit ka probleme. Rruga e fshatit do mirembajtje.

- **Z.Patos Lilo fshati Selenice e Pishes.**

Zona jone eshte pa linje urbane, te shikohet mundesia per ndonje fugon. Duhet te zhblllokohen te shinat e rrugeve te fshatit.

- **Z.Petraq Stefani . Kryeplak i fshatit Luaras.**

Kemi problem me ujesjellsin e fshatit, duam 700 m markuc per te na ardhur uji. Gjithashtu problemi i rruges se fshatit, duhet urgjent nderhyrje.

FOTO – GALERIA E TAKIMIT



Per te shikuar te plote foto – galerine e ketij konsultimi klikoni linkun:

<https://konsultimivendor.al/bashkia-kolonje-nj-a-clirim-degjese-publike/>

Mbajtese Protokolli: Sofika Rrexhepi – Sekretare e Pergjithshme / Bashkia kolonje